



VENDIM MBI PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2015-05

Teresa Peters

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar me 7 maj 2015.

II. FAKTET

2. Në vitin 2010, znj. Teresa dhe z. Harry Peters kishin raportuar në EULEX një person X, qytetar i Kosovës, për mashtrim, kalim të jashtëligjshëm të kufirit dhe diskreditim të padrejtë të një zyrtari të EULEX-it.
3. Ankesa ishte proceduar nga një zyrtar i EULEX-it, por më pastaj ishte dërguar tek prokurori publik në Gjilan, pasi ajo ishte jashtë juridiksionit të EULEX-it, me të cilën znj. Peters nuk është dakord.
4. Z. Peters pretendon se personi X kishte shpërdoruar paratë nga disa gra nga vende të ndryshme në Evropën Perëndimore; kishte bërë kalim të paligjshëm të kufive; dhe ka sugjeruar se ai mund të ishte i përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore dhe korrupsion dhe krime të tjera të rënda.
5. Në lidhje me krimet e ndryshme të pretenduara të personit X, znj. Peters ka pasur komunikim në formën e shkëmbimit të letrave dhe postës elektronike me një prokuror holandez, prokurorin e PSRK-së të EULEX-it, ambasadorin holandez në Kosovë dhe më pas ky i fundit kishte pasur komunikim me Ministrinë e Drejtësisë të Kosovës.
6. Znj. Peters ka kontaktuar EULEX-in në prill të vitit 2012 dhe të gjitha kërkesat e saj janë regjistruar dhe kanë marrë përgjigje.
7. Me 19/20 prill 2012, znj. Peters ka shkëmbyer letra përmes postës elektronike me një zyrtar të EULEX-it, i cili e ka informuar atë se një aktakuzë është e ngritur ndaj personit X dhe gjykatën në Viti.
8. Më tej znj. Peters ishte në kontakt kryesisht me prokurorin e EULEX-it të PSRK-së. Ky i ka shpjeguar në mënyrë të përsëritur znj. Peters se rasti është hetuar nga zyra e prokurorisë në Gjilan dhe se rasti është jashtë juridiksionit të prokurorëve të EULEX-it.
9. Prokurori i PSRK-së ka dërguar korrespondencën e mëposhtëm tek znj. Peters në lidhje me çështjen në fjalë:
 - një letër e datës 30 nëntor 2012 (në përgjigje të hetimit/ankesës 231/2010, lidhur me një rast të hetimit të mashtrimit, ndaj personit X në Zyrë e Prokurorisë Themelore në Gjilan);
 - një letër në postën elektronike e datës 25 shkurt 2013, si përgjigje ndaj letrës së postës elektronike të datës 22 shkurt 2013 (lidhur me ankesat 28/2013 dhe 231/2010, sipas tekstit të postës elektronike);
 - një letër e datës 6 mars 2013 (lidhur me ankesën 231/2010 dhe ankesën 36/2013, e cila është e lidhur me 28/2013 dhe 231/2010 dhe lidhet me pretendimin për përdorimin e kartelës së identifikimit të EULEX-it nga personi X).

10. Në letrën e saj të datës 6 shkurt 2013, prokurori i PSRK-së përsëri i ka shpjeguar znj. Peters se rasti është jashtë juridiksionit të EULEX-it, se EULEX-i nuk ishte përfshirë në hetim dhe se EULEX-i ka përfunduar hetimet e tij në rastin e saj (znj. Peters).
11. Pas kësaj nuk ka pasur korrespondencë të mëtejshme me EULEX-in.
12. Dosja që ankuesi i ka ofruar Panelit, përfshin gjithashtu disa letra, një korrespondencë ndërmjet ambasadorit holandez në Kosovë dhe Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës dhe një vendim të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me të cilin rasti i personit X është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Apelit.

III. ANKESAT

13. Znj. Peters ankohet se EULEX-i është “duke e kundërshtuar pretendimin e tyre” se ata (z. Peters dhe ajo vetë) asnjëherë nuk ishte “mbështetur” nga EULEX-i. Ajo nuk e përmend ndonjë shkelje të veçantë të të drejtave themelore të saj. Mund të merret mbi bazën e parashtrimeve të saj se ajo është duke u ankuar në lidhje me atë që ajo e konsideron si përgjigje jo të duhur nga ana e EULEX-it ndaj kërkesave të saj që personi X të ndiqej penalisht dhe të dënohej për shkeljet e tij të dyshuara.

IV. LIGJI

14. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
15. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
16. Paneli rithekson se instrumentet ligjore të përmendura më sipër nuk japin të drejtë për “hakmarrje” ose për një *actio popularis*. Kështu e drejta që një palë e tretë të gjykohet ose dënohet për ndonjë veprë penale nuk mund të ushtrohet në mënyrë të pavarur: duhet të jetë e pandashme nga ushtrimi i të drejtës së viktimës për të sjellë proceset civile në ligjin vendor, edhe nëse vetëm që të sigurohet dëmshpërblim simbolik ose për të mbrojtur një të drejtë civile siç është e drejta për

“reputacion të mirë” (shih GjEDNj-në, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i 21 shkurtit 1975, Seria A nr. 18, fq. 13, § 27, Tolstoi Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykimi i datës 13 korrik 1995, Seria A nr. 316-B, fq. 78, § 58 dhe Perez kundër Francës [GC], nr. 47287/99, 12 shkurt 2004, § 70). Edhe pse supozohet që znj. Peters e konsideron veten viktimë të shkeljeve të supozuara të personit X, ajo nuk i është referuar ndonjë fakti konkret që do të mbështeste një sugjerim të tillë. Ajo nuk pretendon se ka qenë vetë viktimë e mashtrimit apo ndonjë krimi tjetër që pretendohet nga personi X (shih për shembull, *Faik Ibishi kundër EULEX-it*, 2012-07, 15 janar 2013; *Shefqet Emërllahu kundër EULEX-it*, 2012-15, 8 prill 2013).

- 17 Në çfarëdo rasti, sipas Rregullës 25, paragrafi 3, i Rregullores së Punës, ankesa lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana duhet të paraqitet brenda afatit 6 mujor nga data e shkeljes së supozuar.
- 18 Mund të ketë konsideratë të veçantë në raste të jashtëzakonshme kur një parashtrues i ankesës së pari shfrytëzon mjetin juridik në lidhje me shkeljen e supozuar dhe vetëm në një fazë të mëvonshme informohet ose duhet të jetë i informuar rreth rrethanave që e bëjnë atë mjet të paefektshëm. Në një situatë të tillë, periudha gjashtëmujore mund të llogaritet nga koha kur aplikanti informohet ose duhet të jetë i informuar rreth këtyre rrethanave (shih GjEDNj-në, *Brunner kundër Turqisë* (vendim), nr. 10/10, 6 dhjetor 2011).
- 19 Paneli thekson se në rastin në fjalë ka pasur disa komunikime nga PSRK-ja e EULEX-it tek znj. Peters dhe e fundit është e datës 6 mars 2013. Ankesa e znj. Peters në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ishte regjistruar më shumë se dy vjet më vonë, me datën 7 maj 2015 (nënshkruar nga znj. Peters me datën 5 maj 2015).
- 20 Duke pasur parasysh natyrën e përsëritur të refuzimit të PSRK-së për të hetuar shkeljet e supozuara të personit X, duhej të ishte e qartë për znj. Peters, më së largu në mars të vitit 2013, se nuk do të inicioheshin në emër të PSRK-së veprime konkrete për të hetuar personin X. Në këto rrethana, ajo duhej të kishte paraqitur ankesën e saj brenda gjashtë muajve nga përgjigjja e prokurorit e muajit mars 2013. Ajo nuk e kishte bërë atë dhe nuk ka dhënë shpjegime për mos realizimin e saj.
- 21 Nga kjo rrjedh se kjo ankesë është parashtruar jashtë afatit kohor prej 6 muajsh sipas Rregullës 25 të Rregullores së vet të Punës dhe prandaj është e papranueshme pasi është jashtë afatit.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konsideron se ankesa është parashtruar jashtë afatit kohor prej 6 muajsh sipas Rregullës 25 paragrafi 3 të Rregullores së punës dhe për këtë arsye

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese